POSTIM ARKIVOR

# Baba Faja (1910 - 1947)




SEKSIONI

Klerikë

PERIUDHA

1958 - 1965

Baba Faja, emri i të cilit ishte Mustafa Xhani, lindi në Luz të Madh të Kavajës në vitin 1910. Ishte figurë fetare shqiptare, i përkatësisë bektashiane (sufi), dhe njëkohësisht udhëheqës gjatë Luftës Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar. Që në moshë të re, ndoqi rrugën e formimit fetar, duke studiuar për t’u bërë baba bektashi. Studimet i kreu në Teqenë e Martaneshit, ku edhe mori emrin e tij fetar, me të cilin u bë i njohur si Baba Faja.

# Seksioni 1

Dokumentet arkivore për Komunitetin Bektashian në Shqipëri përkatësisht Fondi 4 Dosja nr. 60 viti 1958 Dosja e objektit per klerin Bektashian ofrojnë një pasqyrë të qartë të menaxhimit dhe kontrollit të aktivitetit fetar nën regjimin komunist. Ato përfshijnë disa vendime kyçe, si ai i datës 30 gusht 1958, që synonin mbajtjen nën kontroll të çdo tentativi armiqësor, dhe ai i 22 korrikut 1965, që pasqyronte stabilitetin dhe uljen e aktivitetit fetar bektashian pas çlirimit.
Një pjesë e rëndësishme e dosjes është historiku i besimit bektashian, që ka pasur një përhapje të gjerë në Shqipëri dhe jashtë saj, me mbi 90,000 besimtarë dhe 67 foltore. Gjatë periudhës së regjimit të Zogut, kleri bektashian kishte një lidhje më të hapur me shtetin, ndërsa gjatë regjimit komunist u përball me kontroll dhe mbikëqyrje strikte.
Pjesa tjetër e dokumenteve flet për strukturën organizative të Komunitetit Bektashian dhe administratën e tij, duke përfshirë listat e klerikëve dhe anëtarëve të rëndësishëm. Ngjarje si Kongresi i IV i Bektashinjve të Shqipërisë dhe transferimi i zyrave në shtëpinë e Baba Fajës janë gjithashtu të dokumentuara, duke theksuar momentet kyçe të organizimit dhe forcimit të këtij besimi në vend.

MEDIA #1

# Struktura organizative e klerit Bektashi

MEDIA FAQE #1



- 5 -

NE SHQIPERI ka afro 90.000 bektashiane dhe 67 faltore.

STRUKTURA ORGANIZATIVE E KLERIT BEKTASHIAN:

Organi me i nalte i besimit bektashian eshte Kongresi dhe mbasi shperndahet Kongresi, eshte Keshilli i pergjitheshem i cili del nga Kongresi. Keshilli i pergjitheshem ka 15 antare nga te cilet 8 jane klerike dhe 9 laike. Keshilli i pergjithshem ka kopetenca te plote deri ne zhgarkimin dhe emerimin e Kryegjyshit te Ri.

Mbas keshillit te pergjitheshem vjen keshilli gjyshnor i (Halifeve) ky merret vetem me çeshtje klerikale (spirtuale) dhe kryesohet nga Kryegjyshi.

Pastaj vjen Kryegjyshi dhe per zonat Keshillat e Gjysherive, per Teqete keshillat e prinderve dhe per Dervishijet keshilli i dervishijes.

Ne Shqiperi jane 6 Gjyshata dhe Kryegjyshata me keto qendra Ne, Tirane eshte Kryegjyshata, kurse gjyshatat jane ne, Elbasan, Kruje, Prishte, Gjinokaster, Korçe, dhe ne Vlore.

Kryesija e keshillit me Kryegjyshin mban lidhje me te gjith gjysherit e te gjashte zonave dhe me Baban e Alifatit te Frasherit.

1-) Gjyshata e Krujes ka tre faltore. 3
2-) " " Prishtes ka 14 faltore.
3-) " " Korçes ka 12 "
4-) " " Gjinokastres ka 11 faltore.
5-) " " Vlores ka 9 "
6-) " " Elbasanit ka 7 "
7-) Alifata e Frasherit e cila ishte qender Gjysherije tash mbahet ne lidhje nga vet Kryegjyshi.

Besimi bektashian ka lindur mbas vdekjes se Muhametit perandorija Arabe u copetua nga besniket e Muhametit dhe si kush pjesen qe mori si trashegim nen administrimin e tija, automatikisht njerezit besonin ne te parin e tyre e keshtu nje nga pjestaret e perandoris ishte dhe Aliu njeriu me besnik ne kohen kur ronte Muhameti qe e ka shpetuar Muhametin nga reziqet. Aliu mbas vdekjes se Muhametit trashegovi nje pjese te perandoris Arabe dhe njerezit qe jetonin nen administrimin e tija ishin te detyruar te besonin dhe te vepronin ashtu si thesh ay, ne kete menyre dhe ketu e ka origjinen besimi Bektashian. Mbas Aliut kane disa pasardhes te tjere qe jane Haxhi Bektash Veliu i cili ka luftuar ne Qerbela kunder Myslimaneve dhe ne kete menyre keto dy besime u armiqesuan me njeri tjetrin dhe krijuan armiqesira te pa pajtueshme me njeri tjetrin. Si Bektashinjte ashtu edhe Synite (Myslimanet) dhe gjith sektet e tjera besojne ne Muhametin dhe familjen e tija, gjithashtu te gjithe besojne ne Kurani, dhe kjo ndodh si kurse u tha me siper se ne kohen e Muhametit perandorija Arabe ishte unike dhe te gjithe besonin udheqesin e tyre qe ishte Muhamedi, por mbasi vdiq ky se cili njeri qe ishte afer Muhametit dhe besniku i tija kerkonte te sundonte vendin e Muhametit, por asnjeri nuk mundi t'ia mbrije qellimit e ne kete menyre nga grindjet e tyre lindi ndarja e Perandorise ne disa pjestare te cilet automatikisht ishin te pare per pjesen qe administronin dhe nvartesit e tyre besonin te parin e tyre qe sot keto jane besime te ndryshme.

Muhamedi simbas goje dhenave ka lindur 571 vjet mbas Krishtit. Krishti si mbas gojedhenave nuk vertetohet te kete egzistuar por duhet te jete ndonje legjende.

Kurani nuk eshte gje tjeter vetem se nje program i Muhametit per te terhequr masat e ndryshme te asaj kohe me vete me qellim qe te fitonte ate post qe fitoj si perandor.

Tirane me 22-Qershor 1954. ! ! ! !

AIDSSH

Struktura organizative e klerit Bektashi

INFORMACION

## Struktura organizative e klerit Bektashi

| | |
|---|---|
| DATA E KRIJIMIT | 1958 |
| | 79 |
| DEGA | II-të |
| DOSJA | Formulare |
| LLOJI I DOKUMENTIT | jpg. |
| GJUHA | shqip |

TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.

MEDIA #2

# Rregullorja e Administrimit të Komitetit Bektashi

MEDIA FAQE #1



R R E G U L L O R J A
E
PËRGJITHËSHME E ADMINISTRIMIT TË KOMUNITETIT BEKTASHIAN SHQIPTAR

Në bazë të nenit 65 të Statutit të Komunitetit Bektashian Shqiptar, Këshilli i Përgjithëshëm i Komunitetit i mbledhur me datë..............950, në Selinë e Shenjtë të Kryegjyshatës Botërore Bektashiane në Tiranë, hartoi dhe pranoi këtë Rregullore të Përgjithëshme t'Administrimit të Komunitetit Bektashian, e cila do t'i paraqitet për aprovim Këshillit Ministruer.

K A P T I N A I.-
KONDITAT E PRANIMIT SI PJESËTAR TË KOMUNITETIT BEKTASHIAN

Neni 1.-

Si konditë e domosdoshme që një Person të jetë Muhib, Dervish, Prind (Baba), Gjysh dhe Kryegjysh, posë konditave të tjera që kërkohen nga nenet e mëposhtëme, duhet të jetë Besnik ndaj Pushtetit Popullor dhe Republikës Popullore të Shqipërisë si edhe luftëtar i vendosur për Mbrojtjen e Paqës.

Neni 2.-

Në koncertin Bektashian mund të dorëzohen personat e të dy seksevet, mashkull dhe femër, pa dallim feje, race dhe origjine, por që kanë mbushur moshën 18 vjeç e lart.

Neni 3.-

Kërkuesi për t'u pranuar në këtë koncert, veç konditave të mësipërme duhet: a) të ketë dashuri për Ehlibejtin dhe pasardhësit e tij; b) të mos jetë çfrytësues dhe të jetojë me anë të çfrytësimit të njeriut; c) të mos ketë të meta fizike; 4) të ketë një të kaluar të pastër e të mos njifet si njeri përtac e me vese të këqija.

Neni 4.-

Mbassi të vërtetohen cilësitë dhe konditat e sipërme tek kërkuesi, simbas traditavet të shenjta bektashiane, pranohet kandidati për Myhib n'Erqanin (mbledhjen e parë).

Neni 5.-

Për t'u konsakruar një Myhib si Dervish duhet: a) të ketë marrë pëlqimin e Prindërvet ose të Prindërit pasjetues; b) të shërbejë NJË MIJ E NJË ditë në Institutin mvartës; c) gjatë gjithë kohës si kandidat të ketë pasë sjellje të mira e të përshtatëshme

Rregullorja e Administrimit të Komitetit Bektashi

MEDIA FAQE #2



- 2 -

për një Dervish.

Neni 6.-

Kandidati për Dervish mbassi përmbush konditat e sipërme mbi kërkimin e tij me këmbëngulje që të mveshi Petkun Fetar, i jepet e drejta e Emërimit si Dervish i klasit të II-të dhe i caktohen detyrat e shërbimit të tij fetar.

Neni 7.-

Për t'u konsakruar "MYXHERRET" (Fidai) Dervishi duhet të shërbejë NJËMIJ E NJË ditë në Qendrën e Kryegjyshatës së Përbotëshme Bektashiane. Konsiderohet shërbimi i kryer në Kryegjyshatë edhe kur Dervish i qëndron pranë një Instituti Bektashian "Myxherret" me konditë që shpenzimet e Ceremonisë së Konsakrimit ti bëjë Instituti mvartës (Halifata, Gjyshata, Prindërija ose Dervishija).

Neni 8.-

Asnjë Dervish "Myxherret" nuk mund të bëhet Mutohil dhe anasjelltas asnjë Dervish Mutehil nuk mund të bëhet Myxherret.

Neni 9.-

Në raste të jashtëzakonshme dhe kur provohet se një Dervish e meriton të konsakrohet "Myxherret" kjo e drejtë i jepet edhe para mbushjes së afatit të NJËMIJ E NJË ditëvet.

Neni 10.-

Për t'u konsakruar Baba (Prindë) ose Gjysh , Dervishi duhet të ketë këto kondita:
a) Të ketë parë Erqanin e Myxherretllikut;
b) Të jetë i pajisur me dijturi fetare të nevojëshme për me përmbushur misionin e tij si Udhë-rrëfenjës;
c) Të ketë dhënë prova të një administratori të mirë;
d) Të ketë marrë pëlqimin unanim të Muhibvet të juridiksionit fetar që e kërkon.

Neni 11.-

Kur konkurojnë Konditat e sipërme kërkesa me anë të Gjyshatës i përcillet kryegjyshatës dhe mbassi vendoset pranimi i kërkesës konform dispozitave të nenit.... të Statutit, Babajt të konsakruar i dorëzohet Dekreti.

Neni 12.-

Mbi propozimin dhe pëlqimin e elementit bektashi të juridiksionit përkatës, mund të dorëzohen baballarë dhe Dervisha Myhibët kur konkurojnë konditat tjera të Nenit 9 të kësaj Rregulloreje.

Neni 13.-

Të gjitha Gjyshatat që ndodhen jashtë botës shqiptare

Rregullorja e Administrimit të Komitetit Bektashi

MEDIA FAQE #3



- 3 -

iu njifet e drejta të dorëzojnë Baballarë.

Neni 14.-

Një Gjysh ose Prind mund të dorëzohet Halife kur janë të plotësuara kondita e mëposhtëme:
a) Të jetë i përsosur nga çdo pikëpamje dhe të mos ketë ndonjë të metë fizike apo dobësi mendore;
b) Të jetë i dalluar për dashurinë e tij ndaj njerëzimit përparimtar.

Neni 15.-

Gjyshërit dhe Prindërit që çmohen se kanë cilësit e sipërme konsakrohen Halifej simbas traditavet të shenjta bektashiane dhe konformë dispozitave të Statutit të Komunitetit.

Neni 16.-

Halifejt konsakrohen vetëm në Selinë e Portës së Lartë të Pirit (Kryegjyshatë).

Neni 17.-

Një Halife për të okupuar postin e shenjtë të Kryetarit të Komunitetit Bektashian duhet të dallohet për këto cilësira e kondita:
a) Të zotërojë mirë Filozofinë bektashiane;
b) Të ketë parë Erqanin Myxherret e Halife;
c) Të jetë i dalluar për sjelljet e tija humanitare dhe të jetë një administrator i dalluar.

Neni 18.- Myhibvet që me sjelljet e tyre i kanë bërë shërbime të mëdha kauzës së Bektashizmit mbi propozimin e Halifejvet iu jepen nga Kryegjyshi Botëror Tituj Nderi, pa të drejtë Erqani si Dervish, Baba e Halife.

KAPTINA II

DETYRAT DHE TË DREJTAT E BEKTASHINJVET QË NGA MYHIBI (BESNIKU) DERI TEK KRY EGJYSHI

Neni 19.-

Çdo Myhib, Dervish, Prind (Baba), Gjysh e Kryegjysh duhet të jetë Besnik i Pushtetit Popullor dhe i Republikës Popullore të Shqipërisë, të zhvillojë ndjenjat Patriotike ndaj Atdheut, dhe të jetë i bindur karshi Ligjëvet të Pushtetit njëkohësisht ti respektojë këto.

Neni 20.-

Myhibi karshi Komunitetit Bektashian dhe traditave të shenjta Bektashiane ka këto detyra:

ADSSH

Rregullorja e Administrimit të Komitetit Bektashi

MEDIA FAQE #4



- 4 -

a) Të jetë i disiplinuar dhe të respektojë eprorët e tij fetarë;
b) të mbrojë nderin e interesin e tjetrit si nderin dhe interesin e tij; c) të shikojë detyrën shpirtërore një herë në vit pranë Udhërrëfenjësit të tij; këtë detyrë për arësye largësije dhe me lejen e Udhë-rrëfenjësit të tij mund ta kryejë pranë një Udhë-rrëfenjësi tjetër, dhe në mungesë të një Udhë-rrëfenjësi, pranë një Myhibi më të vjetër dhe ky i fundit mbassi të kryejë formalitetet e më të rinjvet edhe vetë e përmbush këtë detyrë tek një nga ata; d) të mbajë Matemin dhe të studjojë Historinë e Bektashizmit; e) të frekuentojë Teqetë dhe të marri pjesë aktive në mbledhjet Bektashiane sa më shpesh; f) të mbrojë në raste nevoje interesat e Komunitetit Bektashian.

Neni 21.-

Të drejtat e Myhibve si pjestarë të Komunitetit janë:
a) të priten e përcillen në çdo Teqe si bir i familjes; b) të kërkojnë ndihmën morale nga Udhë-rrëfenjësi (nga eprorët Klerikë dhe nga Myhibët më të vjetër). c) të marrin pjesë në mbledhjet e Këshillavet Bektashiane lokale të Juridiksionit të tyre dhe të çfaqin mendimet e tyre lirisht për punët dhe mbarëvajtjen e Komunitetit Bektashian.

Neni 22.-

Detyrat e Dervishavet janë këto:
a) Të fuajnë traditat e hospitalitetit ndër Qendrat fetare Bektashiane dhe të presin me dashamirësi Vizitorët qofshin këta të Komunitetit Bektashian apo jo.
b) Të studjojnë dhe të zgjërojnë kulturën e tyre fetare në mënyrë të pandërprerë që të fitojnë kështu cilësitë e një fetari dhe predikuesi të mbaruar.
c) Të mos shkelin traditat e shenjta Bektashiane dhe zakonet e mira të vëndit ku jetojnë.
d) Të duan dhe të ndihmojnë njëri-tjetrin dhe të mos bëhen grumbullues të hollash dhe pasurirash private.
dh) Të mos merren me punë të Dynevisë: martesa, fejesa, dasma, huara, kamata, dhe të tjera gjëra që ulin prestigjin e një fetari.
e) Të predikojnë Paqën, Bashkimin dhe vëllazërimin e Popujvet mbi faqen e Dheut.
f) Të mos dalin jashta Teqes pa punë fetare dhe të mos bëjnë gjë pa lejen dhe konsultimin e eprorëvet.

Neni 23.-

Dervishët në gjirin e Komunitetit Bektashian gëzojnë të

ADSSH

Rregullorja e Administrimit të Komitetit Bektashi

MEDIA FAQE #5



- 5 -

(13)

gjitha të drejtat që gëzon një bir në familjen e tij dhe veçanërisht
a) Kanë të drejtën të mvishen e të mbathen me t'ardhurqat e Teqes ashtu siç e lyp dinjiteti i një kleriku Bektashian;
b) T'u sigurohet dhe garantohet mjekimi dhe jetesa në Pleqësi me shpenzimet e Teqes ku shërbejnë;
c) Kanë të drejtën e pushimit vjetor për një muaj, për me e kalue pranë familjevet të tyre ose në ndonjë Teqe tjetër. Leja u jepet gjithënjë në Hanën e Seferit; Nijazet personale janë të tyre.

Neni 24.-

Prindërit përveç detyrave dhe të drejtave që iu njifen dervishvet në dy nenet e sipërmë kanë edhe këto detyra:
a) Të mbajnë e të mbrojnë me besnikëri rrugën e shenjtë të Muhamed-Aléut;
b) Të predikojnë Paqën, Bashkimin dhe Vëllazërimin e popujvet mbi faqen e dheut;
c) T'edukojnë Dervishët dhe sëbashku me ta të rrënjosin në zemrat e besnikëvet Fenë e Muhamed-Aliut në udhën e ndritur të Haxhi Bektashi Veliut;
d) T'edukojnë Besnikët që të ruajnë të paprekur besimin dhe ndërgjegjen e tyre dhe të mos cenojnë besimin dhe ndërgjegjen e tjetrit.
dh) Të shkojnë në harmoni me të gjithë prijësat e Besimeve të tjera;
e) Të kontrollojnë rregullin dhe pastërtinë nëpër Teqe dhe sidomos në Mejdan që është pasqyra e Teqes;
f) T'u paraqesin Gjyshatavet respektive dy herë në vit, raportin mbi gjendjen e Teqeve të tyre dhe t'atyreve mvartëse;
g) Të mbajnë në rregull Librin e vendimeve të Këshillit Lokal të Prindërisë ose Dervishijes, librin e Përgjithëshëm të Llogarive, Librin e protokollit, Librin e dorëzimit të aktevet, regjistrin e Klerikëvet dhe të Myhibvet të juridiksionit të tyre;
gj) Të'i dërgojnë çdo vit Gjyshatës respektive listën e Myhibvet të rekomanduar.

Neni 25.-

Halifejt (Gjyshërit) veç detyrave që iu vihen përpara Prindërvet dhe dervishavet të parapara në nenet: 21, 22 e 23 të kësaj Rregulloreje, kanë edhe këto detyra:
a) Të mbrojnë me besnikëri Amanetet e Halifellikut;
b) T'edukojnë në frymën e shenjtëruar të Haxhi Bektashi Veliut të gjithë Prindërit, Dervishët dhe Myhibët e juridiksionit të tyre;
c) Halifejt (Gjyshërit) jashtë Republikës Popullore të Shqipërisë dhe jashtë Demokracivet Popullore që bëjnë pjesë në Kampin e Paqës.

ADSSH

Rregullorja e Administrimit të Komitetit Bektashi

MEDIA FAQE #6



- 6 -

(14)

që kryejnë Misionet e tyre të shenjta kanë detyrë të mbrojnë të drejtat e klerikëvet dhe elementit Bektashian nga çdo shkelje e padrejtë apo padrejtësi që mund të bëhet karshi tyre; këto kur janë të vazhduarshme të njoftohet Selija e shenjtë e Komunitetit Bektashian;
d) Të shkrijnë jetën e tyre për mbrojtjen e Dritës së Muhamed-Aliut që është besimi i tyre, por në asnjë mënyrë nuk iu lejohet të bëhen shkaktarë të derdhjes së gjakut;
dh) Të ngushëllojnë dhe të ndihmojnë të mjeruarit;
e) T'i paraqesin dy herë në vit Këshillit të Përgjithëshëm të Komunitetit raportin mbi gjendjen e përgjithëshme të Teqevet mvartëse.
f) T'inspektojnë Teqet mvartëse dhe të mbajnë në rregull korrispondencën;
g) T'i raportojnë Kryesisë së Komunitetit ngjarjet e jashtëzakonshme në juridiksionin e tyre që kanë lidhje me misinin e tyre fetar dhe mbarëvajtjen e teqevet.

Neni 26.-

Veç detyravet parimore që patashifen në Nenin 33 të Statutit të Komunitetit Bektashian, Kryegjyshi Botëror ka edhe këto detyra:
1) Të mbrojë me besnikëri të drejtat e Komunitetit Bektashian Botëror dhe të ndërhyje e të protestojë kundër shleljeve të këtyre të drejtavet;
2) Të edukoje e të udhëheqi gjithë Klerin Bektashian Botëror në udhën e ndritur të Haxhi Bektashi Veliut.
3) Të mbajë besnikërisht dhe të bëjë që të respektohen traditat e shenjta bektashiane.
4) Të mbikëqyri gjithë klerin bektashian në misionin e tij dhe të marri masat disiplinore që parashef kjo Rregullore, Statuti i Komunitetit dhe traditat Bektashiane, kundër shkëlësvet dhe devijuesve të Udhës së shenjtë të Haxhi Bektashi Veliut.

K A P T I N A III
ADMINISTRIMI I TEQEVET DHE RENDI I MBRENDËSHEM

Neni 27.-

Teqet administrohen nga Post-nishinët (Titullarët) e tyre që mund të jenë simbas klasifikimit, Gjyshër, Prindër ose Dervish Titullarë. Selije e shenjtë e Kryegjyshatës administrohet drejt për së drejti nga Kryegjyshi Botëror.

Neni 28.-

Post-Nishnat në përmbushjen e misioneve të tyre administratibe, ndihmohen nga këshillat Lokale respektive, të formuara kon-

ADSSH

Rregullorja e Administrimit të Komitetit Bektashi

INFORMACION

## Rregullorja e Administrimit të Komitetit Bektashi

| | |
|---|---|
| TIPOLOGJIA E DOSJES | formulare |
| NUMRI I FAQEVE | 79 |
| GJUHA | shqip |
| VITI | 1958 |

TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.

MEDIA #3

# Kongresi i IV bektashi

MEDIA FAQE #1



30 (33)

Kongresi i IV-të i Bektashijve të Shqipnis u mblodh më 5 Maj 1945, prej të cilit si rrjedhim dolli krijimi i "Komunitetit Bektashian Shqiptar". Në kohën e mbledhjes së këtij Kongresi, ishte si Kryegjysh Botnor i Bektashijve (nga që deri n'atë kohë nuk kishte kryesi Komuniteti, sepse nuk ishte deklaruar akoma) Xhafer Sadik Dedeja, ku për arsye inkapaçiteti dhe pleqërije, kryesinë gjatë seancave të Kongresit ia ngarkojë Baba Fajës.

Unë personalisht ishnja delegat i Bektashijve të qytetit të Tiranës në këtë Kongres, dhe në dy seancat e fundit të tij kam krye edhe detyrën e Sekretarit. Në Kongres u pyet nga një delegat kështu: "Na thuani se a ekziston ndonjë dispozitë n'urdhërin Bektashian që nuk lejohet martesa e klerikve?" Baba Faja si Kryetar u çua dhe i dha spjegime të gjera, të cilat përfunduan me fjalën "për klerikët Bektashian është e lirë martesa". Ky spjegim e përfundim i Baba Fajës pati një pëshpëritje jo të mirë (sepse si delegatë shumica ishin të vjetër dhe fanatikë) dhe në këtë çast Baba Fejzo çohet, ku me një fjalë të gjatë i rrëzojti poshtë spjegimet e Baba Fajës, dyke përfunduar: "Jemi Bektashij dhe do të vdesim Bektashij të pa martuar". Nga kjo duartrokitet nxehtësisht. Kjo është origjina e parë e deklarimit të reformës së martesës.

Mbassi u lexua dhe u aprovua statuti i Komunitetit Bektashian nga Kongresi, Komisioni që pati qenë ngarkuar për përpilimin e Statutit, bëri propozimin e personelit që do të dirizhonte zyrat (Sekretariatin) e Komunitetit. U propozua si Shef i Sekretariatit Baba Faja dhe si sekretar i Sekretariatit (me propozimin e Baba Fajës) unë, ku pranohem mbas një paraqitje që bëri Baba Faja përsa i takonte personit t'im.

Mbas Kongresit – siç e theksova – mbeti si Kryetar i Komunitetit Bektashian Shqiptar dhe Kryegjyshi Botnor i Bektashijve Xhafer Sadik Dede i cili jetojë veçse tre muaj mbas kësaj date; vdiq më 2 Gusht 1945. Gjatë tre muajve të jetës së tij unë dhe Baba Faja i transferuam zyrat e Komunitetit në qytet (në shtëpin e Baba Fajës) nga që Xhafer Sadik Dedej ushqente një mëri të madhe kundrejtë personavet tonë, për shkak të konservatorizmit të madh që kishte, sa që nuk pranonte as me firmuar korespondencën e Komunitetit si Kryetar. Korespondenca u firmonte nga Baba Faja.

AIDSSH

Kongresi i IV bektashi

INFORMACION

## Kongresi i IV bektashi

| | |
|---|---|
| GJUHA | shqip |
| DOSJA | formulare |
| FONDI | 4 |
| | 79 |
| VITI | 1958 |
| NR. | 60 |

TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.

MEDIA #4

# Foto të Baba Fajës

MEDIA FAQE #1




Foto të Baba Fajës

MEDIA FAQE #2



Foto të Baba Fajës

INFORMACION

## Foto të Baba Fajës

| | |
|---|---|
| DOSJA | Nr. 22 |
| DATA E KRIJIMIT | 1952 |
| | 42 |
| | jpg |
| DEGA | II-të |
| GJUHA | shqip |

TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.